

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7974
E mërkurë, 22 janar 2025
Çmimi 0.50 €

Ish-këshilltari juridik i UNMIK-ut në Hagë: Nuk më kujtohet ta kem parë Thaçin duke i dhënë urdhra dikujt



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TRUMPI PEZULLON PËR 90 DITË NDIHMAT NDËRKOMBËTARE AMERIKANE



Presidenti i ri i Amerikës, Donald Trump, ka nënshkruar një urdhër ekzekutiv, i cili ka pezulluar për 90 ditë të gjitha programet e ndihmës

ndërkombëtare të ShBA-së, derisa të shqyrtohen nëse ato janë në përputhje me objektivat e tij politike. Po ashtu, Trumpi, në mesin e urdhrave të parë, ka

nënshkruar edhe atë për faljen e mbi 1 500 personave të akuzuar për krime në trazirat e 6 janarit të vitit 2021 në Kapitolin e ShBA-së

HAMZA TAKOHET ME WALKERIN: E FTOVA TË JETË OBSERVUES I FESTIVALIT TONË TË DEMOKRACISË NË KËTO ZGJEDHJE NACIONALE F.3



AIP-I KËRKON NGA PARTITË POLITIKE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË QYTETARËVE GJATË FUSHATËS F.3

AKTUALE



PËRKUJTOHET IBRAHIM RUGOVA F.7

OSMANI: DËRGOVA DELEGACION NË INAUGURIMIN E TRUMPI, E KAM URUAR PERSONALISHT DHE KAM BISEDUAR ME TË F.5

KQZ-JA AKREDITON EDHE 15 889 VËZHGUËS TË SUBJEKTEVE POLITIKE F.3

KURTI UDHËTON PËR NË ZVICËR, DO TË NËNSHKRUHET MARRËVESHJA E TREGTISË SË LIRË ME VENDET ANËTARE TË EFTA-S F.6

EKONOMI



MINISTRI MURATI THOTË SE KOSOVA KA PASUR INFLACION MË TË ULËT NË VITIN 2024 F.8

SUPER TË PASURIT PO PASUROHEN EDHE MË SHUMË F.8

SPORT



SOT DY NDESHJE NË SUPERLIGË, DY TË TJERA NESËR F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Të paktën 66 të vdekur nga një zjarr në një resor skijimi në Turqi

SIVAS, 21 JANAR - Një zjarr në një resor të njohur skijimi në pjesën veriperëndimore të Turqisë ka lënë të paktën 66 persona të vdekur dhe 51 të tjerë të plagosur, tha ministri i Brendshëm i Turqisë, Ali Yerlikaya. "Jemi në dhimbje të thellë. Fatkeqësisht kemi humbur 66 jetë në zjarrin që shpërtheu në këtë hotel", u ka thënë gazetarëve Yerlikaya pas inspektimit të vendit të ngjarjes. Ministri i Shëndetësisë, Kemal Memisoglu, ka thënë se të paktën një nga të plagosurit ishte në gjendje të rëndë. Zjarri ka shpërthyer rreth orës 3:30 të mëngjesit në restorantin e hotelit 12-katësh "Grand Kartal" në resorin "Kartalkaya",

në provincën Bolu, kanë raportuar zyrtarët dhe mediet lokale.

Shkaqet prapa zjarrit janë ende duke u hetuar. Dy nga viktimat humbën jetën duke kërcyer nga ndërtesa në panik, ka thënë guvernatori Abdulaziz Aydin, për agjencinë shtetërore të lajmeve "Anadolu".

Televizioni "NTV" ka raportuar se disa persona u përpoqën të zbrisnin nga dhomat e tyre duke përdorur çarçafë dhe batanije.

Autoritetet turke kanë arrestuar katër të dyshuar, përfshirë pronarin e hotelit, në lidhje me këtë rast.

"Si pjesë e një hetimi të udhëhequr nga gjashtë prokurorë janë arrestuar katër



persona, përfshirë pronarin e hotelit", ka thënë ministri i Drejtësisë i Turqisë, Yilmaz Tunc.

Në hotel ndodheshin 234 mysafirë, ka thënë guvernatori

Aydin. Ende nuk dihet asgjë për nënshitetësinë e viktimave.

Necmi Kepcetutan, një instruktor skijimi në hotel, ka thënë se ishte në gjumë kur ka shpërthyer zjarri dhe ka dalë me

shpejtësi nga ndërtesa. Ai i ka thënë televizionit "NTV" se më pas ka ndihmuar rreth 20 mysafirë të dilnin nga hoteli.

Ai ka treguar se hoteli ishte mbuluar nga tymi, duke ua bërë të vështirë mysafirëve gjetjen e daljeve emergjente. "Unë nuk mund të vë kontakt me disa nga studentët e mi. Shpresoj të jenë mirë", ka thënë instruktori i skijimit për televizionin.

Pamjet televizive tregonin çatinë dhe katet e sipërme të hotelit të përfshira nga zjarri. Dëshmitarët kanë thënë se sistemi i alarmit të zjarrit në hotel nuk ka funksionuar. Qeveria turke ka caktuar gjashtë prokurorë për ta udhëhequr hetimin mbi zjarrin.

Opozita malazeze bllokoi seancën e Kuvendit dhe miratimin e buxhetit



Opozita në Mal të Zi, e udhëhequr nga Partia Demokratike e Socialistëve (DPS), e ka bllokuar seancën e 21 janarit në Kuvend, ku në rend dite ishte diskutimi dhe miratimi i buxhetit të vitit 2025.

Pasi kryetari i Kuvendit, Andrija Mandiq, e ka hapur seancën, deputetët e opozitës u ngritën nga vendet e tyre dhe dolën para tij. "Shikonë se në

çfarë kushtesh punojmë, ndërkohë që duhet të diskutojmë një çështje të rëndësishme. Autoriteti i Kuvendit po vihet në pikëpyetje", ka thënë Mandiq. Ai ka paralajmëruar se deputetët që janë ngritur nga vendet e tyre do të marrin masa ndëshkuese me shkrim. Mandiq nuk ka specifikuar se kur do të vazhdojë seanca. Opozita i ka penguar seancat

parlamentare që nga 20 dhjetori, duke kërkuar të anulohet vendimi për pensionimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, Dragana Gjuranoviq, i marrë po atë muaj. Sipas opozitës, ky vendim ka qenë i paligjshëm.

BE-ja ofron ndihmë

Bllokimi i punimeve në

Kuvendin e Malit të Zi u diskutua edhe gjatë vizitës zyrtare të komisionares evropiane për Zgjerim, Marta Kos, në Mal të Zi, e cila ka ofruar ndihmën e Komisionit Evropian për normalizimin e punës së Kuvendit.

Delegacioni i BE-së ka propozuar përfshirjen e Komisionit të Venecias - një organ këshillues i Këshillit të Evropës - në zgjidhjen e krizës kushtetuese dhe parlamentare. Edhe pse DPS-ja nuk e refuzoi publikisht këtë propozim, kryeministri malazet Milojko Spajiq e akuzoi atë për aktivitete antievropiane.

Deputeti i opozitës nga Social-demokratët, Nikolla Zirojeviq, ka thënë se nuk ka vend për kompromis kur shkelet Kushtetua. "Nuk e di se si duhet ta komunikojmë, ta shkruajmë, ta vizatojmë, ta këndojmë, si me shumicën parlamentare, ashtu edhe me delegacionin e BE-së: nuk negociojmë për respektimin e Kushtetutës së Malit të Zi në Kuvendin e Malit të Zi", ka thënë Zirojeviq.

Kërkesat e opozitës

Përveçse anulimin e pensionimit të gjyqtarëve Gjuranoviq, opozita ka kërkuar edhe nënshkrimin e marrëveshjes me pushtetin për të mos e ndryshuar Kushtetutën në fushën e çështjeve të identitetit dhe as Ligjin për shtetësinë malazeze.

Ndryshime të tilla janë duke kërkuar edhe partitë e ish-Frontit Demokratik prorus, i udhëhequr nga Andrija Mandiq. Konkretisht, ato janë duke kërkuar që serbishtja të bëhet gjuhë zyrtare, duke u barazuar kështu me gjuhën malazeze, dhe liberalizim të shtetësisë, përkatësisht t'u mundësohet edhe shtetasve të vendeve fqinje të bëhen shtetas malazetë.

Përveç opozitës, këto kërkesa i kanë kundërshtuar edhe partitë shqiptare në Qeverinë e Malit të Zi.

Spajiq ka thënë se për to do të vendoset me konsensusin e të gjitha palëve. Opozita, në anën tjetër, ka thënë se nuk do ta lejojë mbajtjen e seancës së Kuvendit deri në plotësimin e kërkesave.

Shefi i ushtrisë izraelite jep dorëheqje për shkak të sulmit të 7 tetorit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë së Izraelit, Herzl Halevi, ka njoftuar të martën se ka dorëzuar dorëheqjen nga detyra, duke e marrë përgjegjësinë për sulmin vdekjeprurës të Hamasit më 7 tetor 2023 në Izrael.

Ndërkohë, ushtria izraelite e ka kryer një operacion të madh ushtarak në Bregun e okupuar Perëndimor të martën, duke i vrarë gjashtë njerëz dhe duke i plagosur 35 të tjerë, sipas Ministrisë

palestineze së Shëndetësisë. Halevi, i cili e mori detyrën në janar 2023, ka thënë se dorëheqja e tij do të hyjë në fuqi më 6 mars.

Gjenerallejtënant Halevi është zyrtari më i lartë izraelit që jep dorëheqje për shkak të dështimit të sigurisë më 7 tetor 2023, kur mijëra militantë të udhëhequr nga Hamas, grupi palestinez i shpallur terrorist nga ShBA-ja dhe BE-ja, u futën në jug të Izraelit dhe sulmuan

komunitetet pranë kufirit dhe bazat ushtarake.

Në atë sulm ishin vrarë 1 200 njerëz, kryesisht civilë dhe ishin rrëmbyer 250 të tjerë. Më shumë se 90 pengje janë duke u mbajtur ende në Gazë, dhe besohet se rreth një e treta e tyre kanë vdekur tashmë.

Lufta në Gaza ka shkaktuar viktima të shumta dhe dëme të mëdha materiale. Si pasojë e ofensivës izraelite janë vrarë më shumë se 46 000 palestinezë.




AIP-i kërkon nga partitë politike mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve gjatë fushatës

PRISHTINË, 21 JANAR - Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) ka kërkuar nga partitë politike mbrojtjen e të dhënave personale gjatë fushatës për zgjedhjet e 9 shkurtit. "Në mbikëqyrje të zbatimit të ligjit, përkatësisht mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve, Agjencia për Informim dhe Privatësi në vitet e fundit ka pranuar ankesa të adresuara nga qytetarët ndaj partive politike për përdorimin e të dhënave personale të qytetarëve në mënyrë të paautorizuar, duke aplikuar marketingun e drejtpërdrejtë, të cilat raste janë trajtuar përkthazi me ligjin", është thënë në reagimin e AIP-it.

Po ashtu, AIP-i ka kërkuar nga partitë politike që të mos i ekspozojnë të dhënat personale gjatë komunikimit nëpërmjet postës elektronike, mesazheve dhe thirrjeve telefonike pa pëlqim paraprak. "Për ta siguruar zbatimin e ligjit, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe njëkohësisht për të shmangur çdo veprim të Agjencisë kundrejt Partive Politike dhe subjekteve të përfshira në procesin e fushatës elektorale, Agjencia kërkon nga Partitë Politike zbatimin e detyrimeve ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve duke mos ekspozuar të dhënat personale gjatë

komunikimit nëpërmjet postës elektronike (e-mail), mesazhet (SMS) dhe thirrjet telefonike, pa pëlqim paraprak. Agjencia ofron bashkëpunim me subjektet politike për të siguruar respektimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe bën thirrje që çdo informacion personal i mbledhur gjatë procesit të regjistrimit të votuesve, për realizimin e komunikimit me qytetarët gjatë aktiviteteve të fushatës zgjedhore, të përdoret në përputhje me kërkesat ligjore", është thënë në reagimin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi (AIP).



Ashpërsohet gjuha në fushatë: PZAP-i i dënon partitë politike 125 mijë euro



Prishtinë, 21 janar - Fushata e partive politike për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit ka filluar zyrtarisht më 11 janar. Megjithatë, kjo fushatë po përcillet me gjuhë dhe retorikë të rrezikshme, e shpesh ofenduese ndaj partive politike. Për këtë arsye, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Prapashtesa (PZAP) ka shqiptuar gjopa në vlerë prej 125 mijë eurosh ndaj subjekteve politike për shkelje të rregullave zgjedhore. Kështu kanë konfirmuar nga PZAP-i për "Lajmi.net", të cilët kanë thënë se gjopat janë shqiptuar për një sërë rastesh që janë shqyrtuar dhe për të

cilat vendimet gjenden në uebfaqen zyrtare të PZAP-it. "Rastet përfshijnë: Anr.27/2025, Anr.28/2025, Anr.30/2025, Anr.32/2025, Anr.34/2025, Anr.35/2025, Anr.37/2025, Anr.48/2025, Anr.49/2025, Anr.50/2025, dhe të tjera deri në Anr.69/2025", ka njoftuar PZAP-i, teksa këto raste janë vendosur te fusha "Rasti i Ankesës" pastaj te "Statusi i rastit" në uebfaqen e këtij institucioni. Në lidhje me gjuhën e përdorur të subjekteve politike për zgjedhjet e 9 shkurtit, ditë më parë pati njoftuar edhe Demokracia në Veprim.

Në një konferencë për medie javën e kaluar, Eugen Zekolli nga DnV-ja ishte shprehur se ka pasur përkeqësim të gjuhës së ashpër të përdorur në fushatë. "Këtë javë kemi pasur ashpërsim e përkeqësim të gjuhës së përdorur në fushatë, me plot 25 aktivitete gjatë monitorimit të të cilave janë raportuar raste të përdorimit të gjuhës së nxitjes apo urrejtjes, kryesisht mbi baza politike", ishte shprehur të shtunën Zekolli. Kujtojmë se zgjedhjet parlamentare do të mbahen më 9 shkurt 2025, ku në garë janë 28 subjekte politike dhe një kandidat i pavarur.

Hamza takohet me Walkerin: E ftova të jetë observues i festivalit tonë të demokracisë në këto zgjedhje nacionale

PRISHTINË, 21 JANAR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Bedri Hamza, ka njoftuar se është takuar me ambasadorin William Walker. Hamza në "Facebook" ka

thënë se Walkeri është hero i lirisë së vendit. Më tutje, Hamza ka thënë se e ka ftuar ambasadorin Walker të jetë "observues i drejtpërdrejtë i festivalit të demokracisë në këto



zgjedhje". "Një kafe me ambasadorin William Walker, heroin e lirisë sonë, zëri i të cilit na dha shpresë dhe i hapi rrugë intervenimit të NATO-s. I kujtuam çastet vendimtare të

historisë së Kosovës, biseduam për aleancën me ShBA-në dhe për mënyrat sesi qeveria ime do ta forcojë aleancën me Perëndimin. Ambasadorin Walker e ftova të

jetë observues i drejtpërdrejtë i festivalit tonë të demokracisë në këto zgjedhje nacionale, të cilat doemos do ta bëjnë Kosovën ma të mirë", ka shkruar Hamza.

KQZ-ja akrediton edhe 15 889 vëzhgues të subjekteve politike

Prishtinë, 21 janar - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka

akredituar edhe 15 889 vëzhgues të 21 subjekteve të ndryshme politike të

cilat janë të certifikuara për pjesëmarrje në zgjedhjet e 9 shkurtit. Në

përgjithësi numri i vëzhguesve të akredituar deri më tani nga KQZ-ja

dhe që u takojnë subjekteve politike është 18 163 vëzhgues.



Trumpi pezullon për 90 ditë ndihmat ndërkombëtare amerikane

Presidenti i ri i Amerikës, Donald Trump, ka nënshkruar një urdhër ekzekutiv, i cili ka pezulluar për 90 ditë të gjitha programet e ndihmës ndërkombëtare të ShBA-së, derisa të shqyrtohen nëse ato janë në përputhje me objektivat e tij politike. Po ashtu, Trumpi, në mesin e urdhrave të parë, ka nënshkruar edhe atë për faljen e mbi 1 500 personave të akuzuar për krime në trazirat e 6 janarit të vitit 2021 në Kapitolin e ShBA-së

WASHINGTON, 21 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, ka nënshkruar një urdhër ekzekutiv, i cili ka pezulluar përkohësisht të gjitha programet e ndihmës ndërkombëtare të ShBA-së për 90 ditë, derisa të shqyrtohen nëse ato janë në përputhje me objektivat e tij politike. Ende nuk është e qartë se si do të ndikojë ky vendim te programet aktuale të ShBA-së për ndihma, pasi financimi për shumë programe tashmë është miratuar nga Kongresi amerikan dhe duhet të shpenzohet, nëse nuk është shpenzuar ende. "Radio Evropa e Lirë" i ka pyetur Ambasadën e ShBA-së dhe Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) nëse ky vendim do të ndikojë në ndonjë mënyrë në ndihmat e parapara për Kosovën por, deri më tani, nuk ka marrë përgjigje. Në uebfaqen e USAID-it është thënë se nga viti 1999 mbi një miliard dollarë janë shpenzuar për zhvillimin e Kosovës. Në tetor të vitit të kaluar USAID-

i ka shënuar 25-vjetorin e themelimit në Kosovë, ku ka zhvilluar programe për luftën kundër korrupsionit, sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë, luftën kundër dezinformimit dhe avokimin e medieve të pavarura, forcimin e shoqërisë civile dhe demokracisë, zhvillimin ekonomik dhe tërheqjen e investimeve të huaja. Në gusht të vitit 2024 presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e kishte nënshkruar një grant me USAID-in, i cili ofronte ndihmë shtesë për institucionet e Kosovës në vlerë prej 34.5 milionë dollarësh. Granti ishte pjesë e marrëveshjes së arritur më parë në vlerë prej rreth 146 milionë dollarësh, që synonte ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët, rritjen e përgjegjësisë së institucioneve dhe menaxhimin më efikas. Aktualisht USAID-i në Kosovë është duke financuar një mori aktivitete. Ndër to janë: ndihma mbi 12 milionë dollarëshe për mbështetjen e reformave legjislative dhe ngritjen e Gjykatës Komerciale; ndihma 15 milionë dollarëshe për ta përmirësuar

gjithëpërfshirjen dhe logaridhënien në qeverisje; ndihma mbi 13 milionë dollarëshe për t'i adresuar sfidat e korrupsionit dhe qeverisjes së mirë në komuna; ndihma gati 12 milionë dollarëshe për përmirësimin e pavarësisë së gjyqësorit dhe priorizimit të nevojave të qytetarëve gjatë proceseve gjyqësore; ndihma mbi 16 milionë dollarëshe për ta promovuar konkurrencën e mirë në tregjet vendore dhe ndërkombëtare; ndihma mbi 13 milionë dollarëshe për pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisjen lokale; ndihma gati 12 milionë dollarëshe për t'i rritur kapacitetet institucionale për zhvillimin e tregut të energjisë. Ndihmat e tilla kanë vazhduar edhe gjatë periudhës kur ShBA-ja dhe BE-ja kanë kritikuar Qeverinë e Kosovës për vendime që kryesisht kanë të bëjnë me jetesën e serbëve në katër komunat me shumicë serbe në veriun e Kosovës, si heqja nga përdorimi e dinarit serb, shpronësimi në veri të Kosovës për ndërtimin e bazave policore, mbyllja e institucioneve paralele që funksionojnë sipas sistemit serb etj. Ndihmësadministratorja në Byronë për Evropë dhe Euroazi në USAID, Erin Elizabeth McKee - pjesë e administratës së ish-presidentit amerikan, Joe Biden - kishte thënë gjatë vizitës së saj në Kosovë vitin e kaluar se fokusi i USAID-it në të ardhmen do të jetë mbështetja e realizimit të reformave në kuadër të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor. "Kjo është një

mundësi reale për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor që të ecin përpara në anëtarësimin në BE dhe të jenë në gjendje jo vetëm t'i kalojnë reformat, por t'i zbatojnë ato në një mënyrë kuptimplote", kishte thënë ajo për "Radio Evropa e Lirë". Por, urdhri, ndër shumë të tjerë që Trumpi ka nënshkruar në ditën e tij të parë pas kthimit në detyrë, ka thënë se "industria dhe burokracia e ndihmës ndërkombëtare nuk janë në përputhje me interesat amerikane dhe në shumë raste janë të kundërta me vlerat amerikane". Më tutje, aty është thënë se këto ndihma "shërbejnë për ta destabilizuar paqen botërore duke promovuar ide në shtetet e huaja që janë drejtpërdrejt të kundërta me marrëdhëniet harmonike dhe stabile brenda dhe midis shteteve". Si pasojë, Trumpi shpalli se "nuk do të shpërndahen më ndihma ndërkombëtare nga Shtetet e Bashkuara në një mënyrë që nuk është plotësisht në përputhje me politikën e jashtme të presidentit të Shteteve të Bashkuara". Javën e kaluar sekretari i ri amerikan i Shtetit, Marco Rubio, u ka thënë anëtarëve të Komitetit të Marrëdhënieve të Jashtme të Senatit, se "çdo dollar që shpenzojmë, çdo program që financojmë dhe çdo politikë që ndjekim, duhet të justifikohet me përgjigjen ndaj tri pyetjeve të thjeshta". "A e bën Amerikën më të sigurt? A e bën Amerikën më të fuqishme? A e bën Amerikën më

të pasur?", ka thënë ai. Urdhri i nënshkruar nga Trumpi e lë në dorë të Rubios ose përfaqësuesit të tij për të përcaktuar se nëse një ndihmë është në përputhje me politikën apo jo, në konsultim me Zyrën e Menaxhimit dhe Buxhetit. Departamenti i Shtetit dhe Agjencia Amerikane për Ndihmën Ndërkombëtare janë agjencitë kryesore që mbikëqyrin ndihmën ndërkombëtare. Trumpi ka kritikuar prej kohësh ndihmën ndërkombëtare pavarësisht faktit se ndihma e tillë zakonisht përbën rreth 1 për qind të buxhetit federal, përveç rrethanave të jashtëzakonshme siç janë miliardat e armatimeve të dhëna Ukrainës. Trumpi ka qenë kritik ndaj shumës së dërguar në Ukrainë për të ndihmuar në forcimin e mbrojtjes së saj kundër pushtimit të Rusisë. Llogaritja e fundit zyrtare e ndihmës ndërkombëtare në administratën e Bidenit tregon se 68 miliardë dollarë janë angazhuar për programe jashtë shtetit që shtrihen nga ndihmat për katastrofa deri te shëndeti dhe iniciativa pro demokracisë në 204 shtete dhe rajone. Disa nga marrësit më të mëdhenj të ndihmës amerikane, Izraeli me 3.3 miliardë dollarë në vit, Egjipti me 1.5 miliard dollarë në vit dhe Jordania me 1.7 miliard në vit, besohet se do të shohin ulje dramatike në financim, pasi këto shuma janë të përfshira në pako afatgjatë që datojnë nga dekada më parë dhe në disa raste janë të rregulluara nga obligime

Osmani: Dërgova delegacion në inaugurimin e Trumpit, e kam uruar personalisht dhe kam biseduar me të

PRISHTINË, 21 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka përsëritur edhe një herë arsyen pse nuk mori pjesë në inaugurimin e presidentit amerikan Donald Trump. Ajo ka thënë se duke marrë parasysh që shumë shtete janë përfaqësuar nga ambasadorët, i njëjti model është zbatuar edhe nga Kosova. "Siç ju kam informuar, në këtë ceremoni kam qenë e ftuar nga anëtarë të Kongresit dhe të Senatit. Meqenëse shumica e shteteve, siç keni mundur ta shihni dje, sa iu përket liderëve shtetërorë që janë udhëheqësesh shtetesh, janë përfaqësuar nga ambasadorët, të njëjtin model

protokollar e kemi zbatuar edhe ne. Unë kam dërguar një delegacion presidencial të udhëhequr nga shefja ime e stafit dhe këshilltarja për politikë të jashtme. Të shoqëruara nga ambasadori ynë në ShBA, Ilir Dugolli, kanë marrë pjesë në të gjitha aktivitetet inauguruese e të cilat, në fakt, ende po vazhdojnë, përfshirë takime të ekipit që unë e kam deleguar dhe sapo të përfundojnë të gjitha takimet e tyre, ne do të lëshojmë një komunikatë ku do ta informojmë publikun për të gjitha këto takime", ka thënë Osmani. Presidentja ka shtuar se ajo e ka uruar personalisht Trumpin

gjatë vizitës në Paris, madje edhe kanë biseduar rreth Kosovës. "Siç e dini, unë tashmë kam pasur mundësi ta uroj personalisht presidentin Trump gjatë vizitës në Paris dhe jo vetëm që ta uroj por, njëkohësisht, të kem edhe një bisedë përmbajtjesore me të lidhur me situatën e sigurisë në Kosovë dhe në rajonin tonë, dhe për rreziqet të cilat i kanosen këtij rajoni. Kam shprehur besimin e plotë në leadershipin e tij për ta ruajtur paqen dhe sigurinë në Kosovë dhe më gjerë dhe për ta thelluar bashkëpunimin. Jam e kënaqur dhe shumë optimiste pas asaj bisede", ka thënë Osmani.



Ziadin Sela: Albin Kurti po e bën punën e djallit, nuk është ai që e kam njohur dikur



SHKUP, 21 JANAR - Kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, ka komentuar përsëri deklaratën e mëhershme të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në lidhje me statusin e gjuhës shqipe në Maqedoninë e Veriut. Sela në "Daily Click" ka thënë se Kurti është duke e bërë punën e djallit dhe nuk është ai që e kam njohur dikur. "Është i keqinformuar në variantin më të mirë. E ka ambasadorin

në Shkup, si mund të keqinformohet? Unë thashë në variantin më të mirë, në variantin më të keq, po e bën punën e djallit dhe nuk është ai kryeministër që unë e kam njohur dikur. Pse? Nuk e di", ka thënë Sela. Sela ka thënë se Albin Kurti nuk duhet të ketë dilema se gjykatësit në Maqedoni t Veriut janë të të njëjtit mentalitet që kanë dhënë dënime për të dënuarit e rastit të Kumanovës dhe ka shtuar

se është e njëjta mendësi që Agim Islamin e ka lënë në burg që, siç ka theksuar, edhe pse janë të gjitha dëshmitë se ai duhet të jetë i lirë. "Është i keqinformuar në variantin më të mirë. E ka ambasadorin në Shkup. Si mund të keqinformohet? Unë thashë në variantin më të mirë, në variantin më të keq, po e bën punën e djallit dhe nuk është ai kryeministër që unë e kam njohur dikur. Pse? Nuk e di", ka thënë Sela.

traktatësh. Financimi për agjencitë e OKB-së, përfshirë agjencitë për ruajtjen e paqes, të drejtat e njeriut dhe refugjatët, kanë qenë tradicionalisht shënjestra për administratat republikane. Administrata e parë e Trumpit e nisi reduktimin e shpenzimeve për ndihmën ndërkombëtare, duke pezulluar pagesat për disa agjenci të OKB-së, përfshirë Fondin e Popullsisë të OKB-së dhe financimin për Autoritetin Palestinez.

Trumpi fal të akuzuarit e 6 janarit, mes vendimeve të para pas kthimit në Shtëpinë e Bardhë

Pak orë pas kthimit në Shtëpinë e Bardhë, presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka nënshkruar edhe disa urdhra të tjerë ekzekutivë dhe direktiva për ta vendosur vulën e tij mbi administratën e re amerikane, në çështje që përfshijnë energjinë, faljet penale dhe imigracionin. Në mesin e urdhrave të parë ishte një falje e përgjithshme e mbi 1 500 personave të akuzuar për krime në trazirat e 6 janarit të vitit 2021 në Kapitolin e ShBA-së. Në mesin e atyre që do të përfitojnë nga kjo falje janë edhe të dënuarit për sulme ndaj zyrtarëve policorë. Veprimi i Trumpit, vetëm disa

orë pas kthimit në Shtëpinë e Bardhë, hap rrugën për lirinë nga burgu të atyre që janë shpallur fajtorë për sulme të dhunshme ndaj policisë, si dhe drejtuesve të grupeve ekstreme të djathta të dënuar për komplotet e dështuara për ta mbajtur në pushtet republikanin pasi humbi zgjedhjet e 2020-s ndaj ish-presidentit Joe Biden. Demokratët kanë kritikuar ashpër vendimin për t'i përfshirë në falje edhe protestuesit e dhunshëm, krimet e shumë prej të cilëve u kapën në kamera dhe u transmetuan drejtpërdrejt në televizione. Trumpi kishte sugjeruar në javët para rikthimit në Shtëpinë e Bardhë se në vend të faljeve të përgjithshme, ai do t'i shqyrtonte të gjitha rastet e të akuzuarve të 6 janarit një pas një. Ndërsa zëvendës-presidenti JD Vance kishte thënë vetëm disa ditë më parë se njerëzit përgjegjës për dhunën gjatë trazirës në Kapitol "natyrisht" nuk duhej të falnin. Trumpi, 78 vjeç, ka bërë betimin si president të hënën në ndërtesën e Kapitolit dhe, gjatë ceremonisë, ai e portretizoi veten si një shpëtimtar të zgjedhur nga Zot për të shpëtuar një komb në rënie. "Unë u shpëtova nga Zot për ta bërë Amerikën të madhe sërish", ka thënë ai. Menjëherë pas betimit të tij si president, autoritetet kufitare të ShBA-së pezulluan një program që lejonte qindra mijëra

emigrantë të hynin ligjërisht në ShBA përmes planifikimit të një takimi përmes një aplikacioni në telefon. Takimet ekzistuese u anuluan. Rreth 1 660 afganë që ishin miratuar nga qeveria amerikane për të emigruar në ShBA, përfshirë anëtarë të familjeve të personelit ushtarak amerikan aktiv, panë se fluturimet e tyre u anuluan si pasojë e një urdhri të Trumpit që pezullonte programet e refugjatëve në ShBA, tha një zyrtar amerikan dhe një avokat për zhvendosjen e refugjatëve. Në Shtëpinë e Bardhë, Trumpi ka nënshkruar edhe një urdhër që shpallte emergjencë kombëtare në kufirin ShBA - Meksikë, që do të çlironte fonde dhe do t'i lejonte atij të dislokonte trupa atje. Ai ka nënshkruar një urdhër për t'i dhënë fund një politikë që ua jep shtetësinë atyre që lindin në Shtetet e Bashkuara, një veprim që me siguri do të shkaktojë një betejë të gjatë ligjore. Një urdhër tjetër ekzekutiv shpalli kartelet e drogës meksikane si organizata terroriste. Trumpi ka tërhequr përsëri Shtetet e Bashkuara nga Marrëveshja e Parisit për klimën, duke larguar kështu ndotësin më të madh historik në botë nga përpjekjet globale për t'i luftuar ndryshimet klimatike për herë të dytë brenda një dekade. Një urdhër tjetër ka tërhequr Shtetet e Bashkuara nga Organizata Botërore e

Shëndetësisë, duke deklaruar se agjencia globale e shëndetësisë kishte keqmenaxhuar pandeminë e Covid-19 dhe kriza të tjera ndërkombëtare të shëndetit. Plani, që përputhet me kritikën e vazhdueshme të Trumpit ndaj agjencisë shëndetësore të OKB-së, përfaqëson një ndryshim dramatik në politikën globale të shëndetit të ShBA-së dhe izolon më tej Uashingtonin nga përpjekjet ndërkombëtare për t'i luftuar pandemitë. "Po heqim gjithë kancerin... të shkaktojmë nga administrata Biden", ka thënë Trumpi, ndërsa nënshkroi një sërë urdhrash ekzekutivë në Zyrën Ovale. Urdhri të tjerë revokuan politikën e administratës Biden mbi inteligjencën artificiale dhe automjetet elektrike. Ai, gjithashtu, urdhëroi punonjësit e qeverisë të kthehen në zyrë, në vend që të punojnë nga shtëpia. Trumpi ka nënshkruar edhe dokumente për të krijuar një "Departament për Efikasitetin Qeveritar", një bord këshillimor i jashtëm i kryesuar nga miliarderi Elon Musk, që synon të kufizojë pjesë të mëdha të shpenzimeve qeveritare. Në Departamentin e Shtetit, dhjetëra diplomatëve të lartë jopartiakë u është kërkuar të japin dorëheqje si pjesë e një plani më të gjerë për t'i zëvendësuar nëpunësit civilë jopartiakë me besnikë. Trumpi ka thënë në rrjetet sociale

se ekipi i tij ishte në procesin e largimit të mbi 1 000 të emëruarve nga administrata Biden. Ai, gjithashtu, ka thënë se do të nxirrte urdhra për t'i hequr programet federale të diversitetit dhe për të kërkuar që qeveria t'i njohë vetëm gjinitë e përcaktuara në lindje. Në një tjetër urdhër ekzekutiv të nënshkruar është thënë se Trumpi synon ta rivendosë lirinë e fjalës dhe t'i japë fund censurës, duke tërhequr kritika nga kundërshtarë që theksojnë veprimet e tij të mëparshme kërcënuese dhe paditëse ndaj gazetarëve, kritikëve dhe kundërshtarëve politikë. Trumpi dhe aleatët e tij republikanë e kanë akuzuar administratën e ish-presidentit demokrat Joe Biden për nxitjen e shtypjes së lirisë së fjalës në platformat online. Megjithatë, shumë nga akuzat kundër administratës së mëparshme janë përqendruar në përpjekjet qeveritare për t'i luftuar pretendimet e rreme mbi vaksinat dhe zgjedhjet. Gjykata e Lartë e ShBA-së vendosi në qershor se qasja e administratës së Bidenit me kompanitë e medieve sociale nuk shkel Amendamentin e Parë të Amerikës për lirinë e shprehjes. Trumpi, i cili mori detyrën të hënën, vetë ishte përballur me kufizime në rrjetet sociale pas sulmit në Kapitolin e ShBA-së nga mbështetësit e tij më 6 janar 2021.

Largohet një kamerë ilegale në Leposaviq, ishte vendosur në një shtyllë elektrike

PRISHTINË, 21 JANAR - Policia e Kosovës ka gjetur një kamerë të kamufluar në një kaperman të elektroverit në magjistralen Mitrovicë - Leposaviq. Kjo kamerë dyshohet se ka vëzhguar lëvizjet e Policisë së Kosovës dhe u takon strukturave paralele. E për këtë çështje zëvendësrejtori i policisë për

rajonin e veriut, Veton Elshani, ka thënë se nuk ka persona të arrestuar, por rasti po cilësohet “incizim i paautorizuar”. Sipas Elshanit, kjo ka qenë kamera e tretë e larguar që ka vëzhguar vendet publike. “Dje në Leposaviq policia ka larguar një kamerë e cila e monitoronte pjesën publike, respektivisht

magjistralen Mitrovicë - Leposaviq. Pas konsultimit me prokurorin, sot është hapur rast - incizim i paautorizuar. Nuk ka persona të arrestuar, ndërsa kjo është kamera e tretë e maskuar e larguar që monitoronte vendet publike. Dy të tjerat kanë qenë në Mitrovicën e Veriut në vitin e kaluar”, ka deklaruar Elshani.



Shkatërrohet grupi i trafikut ndërkombëtar të kokainës, në pranga 5 shqiptarë

Tiranë, 21 janar - Policia e Shqipërisë është angazhuar në megaoperacionin ndërkombëtar “ICARO.AL”, i iniciuar nga autoritetet italiane kundër një grupi kriminal që trafikonte kokainë me automjete nga Amerika e Jugut për ta shitur në Itali dhe në shtete të Evropës Qendrore. Deri tani në kuadër të këtij megaoperacioni janë vënë në pranga 12 shtetas dhe po hetohen 8 të tjerë. Pesë shtetas shqiptarë janë arrestuar në Shqipëri si pjesëtarë të këtij grupi, me qëllim ekstradimit. Në kuadër të megaoperacionit “ICARO.AL”, strukturat për hetimin e krimit të organizuar në DPPSh, ato të drejtorive vendore të policisë së Tiranës dhe Elbasanit, Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale, Forca

Kombëtare e Sigurisë Njësie Tiranë, si dhe Guardia di Finanza, në bashkëpunim me SPAK-un, kanë vënë në pranga shtetasit: Igli Dervishi, 30 vjeç, banues në Elbasan; Shkëlqim Pashja, 44 vjeç, banues në Elbasan; Ervin Dema, 40 vjeç, banues në Elbasan; Edmond Zhuja, 41 vjeç, banues në Shkodër dhe Genti Berisha, 28 vjeç, banues në Tiranë. Më tutje, “euronews.al” ka shkruar se si rezultat i sigurimit të informacionit nga strukturat e policisë shqiptare, dhe shkëmbimit të tij me homologët spanjollë është vënë në pranga në Spanjë shtetasi shqiptar me precedent penal, Gerardo Pashja, alias Astrit Pashja, 48 vjeç. Gjithashtu, gjatë zhvillimit të këtij megaoperacioni në Shqipëri është identifikuar dhe



shpallur në kërkim shtetasi M. M., 28 vjeç, i cili kërkohet edhe për vepra të tjera penale. Në koordinim me partnerët po punohet për lokalizimin dhe arrestimin e këtij shtetasi. Këta shtetas akuzohen nga Gjykata e Breshias, Itali, se të

organizuar si grup, kanë trafikuar lëndë narkotike - kokainë - nga Amerika e Jugut nëpërmjet automjeteve të modifikuara për fshehjen e lëndës narkotike dhe e kanë shitur atë në qytete të Italisë dhe në shtete të Evropës

Qendrore. Interpol Tirana po bashkëpunon me homologët për t'i finalizuar ekstradimet e shtetasve të arrestuar. Materialet procedurale i kanë kaluar SPAK-ut për veprime të mëtejshme.

Kurti udhëton për në Zvicër, do të nënshkruhet marrëveshja e tregtisë së lirë me vendet anëtare të EFTA-s



PRISHTINË, 21 JANAR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka udhëtuar për në Zvicër. Ai do të marrë pjesë në Forumin Ekonomik Botëror në Davos. Sipas njoftimit të zyrës së kryeministrit, në Davos do të nënshkruhet marrëveshje për tregti të lirë me vendet anëtare të EFTA-s (Shoqatën Evropiane të Tregtisë së Lirë). “Në Davos do të nënshkruhet Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me vendet anëtare të EFTA-s (Shoqatën Evropiane të Tregtisë së Lirë). Kosova është i vetmi vend në rajon që përveç negociimit për tregti të

mallrave, ka negociuar edhe për tregti të shërbimeve me EFTA-n. Kjo marrëveshje do të krijojë mundësi të reja për prodhuesit dhe kompanitë tona vendore dhe do të forcojë partneritetin ekonomik dhe tregtar ndërmjet vendit tonë dhe Norvegjisë, Zvicrës, Lihtenshtajnit dhe Islandës si shtete anëtare të EFTA-s”, ka njoftuar zyra e kryeministrit. Gjatë qëndrimit atje, kryeministri Kurti do të ketë takime me përfaqësues shtetërorë të vendeve mike e partnere dhe me investitorë

potencialë, si dhe do të marrë pjesë në panelin e diskutimit me titull “Demokracitë e qëndrueshme në një epokë të ndryshimit” dhe panelin “Inteligjenca artificiale për njerëzimin: inovacioni etik në epokën e inteligjencës”. Të dy këto panele do të mbahen në Shtëpinë e Kosovës (House of Kosova) në Davos e cila është hapur për herë të parë. Në Forumin Ekonomik në Davos marrin pjesë edhe ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari dhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli.

Ushtarët italianë të KFOR-it kryejnë stërvitje intensive për kontrollin e turmës dhe trazirave

Prishtinë, 21 janar - Ushtarët italianë nga Batalioni Kinetik i Komandës Rajonale në Perëndim të KFOR-it kanë kryer një stërvitje intensive të Kontrollit të Turmës dhe Trazirave (CRC). Ata janë trajnuar nga kolegët e tyre hungarezë nga Batalioni i Rezervës Taktike të KFOR-it,

ka njoftuar misioni i NATO-s në Kosovë. “Ky lloj trajnimi vendos një fokus të veçantë në menaxhimin e frikës nga zjarri (Firephobia) dhe në përvetësimin e teknikave për t'i minimizuar dëmet e shkaktuara nga flakët”, ka njoftuar KFOR-i. KFOR-i ka përsëritur se

vazhdon ta zbatojë mandatin e tij - bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999 për të kontribuar në një mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes, “në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme”.



Përkujtohet Ibrahim Rugova

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 21 JANAR - Në 19-vjetorin e vdekjes së presidentit të parë të Kosovës, Ibrahim Rugovës, janë bërë homazhe te varri i tij në lagjen "Velania" në Prishtinë.

Fillimisht presidentja Vjosa Osmani dhe diplomatët e huaj në Kosovë kanë bërë homazhe dhe nderime te varri i Rugovës. Në mesin e pjesëmarrësve në këtë ceremoni ishin e ngarkuara me punë në Ambasadën Amerikane, Anu Prattipati, ambasadori i BE-së në Kosovë, Aivo Orav, shefi i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Giovanni Pietro Barbano, dhe ambasadorë të tjerë të huaj. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka quajtur Rugovën "atin themeltar të shtetit tonë" pasi tha se ai kishte dhënë

e ka lavdëruar Rugovën për vizionin e tij, që ka thënë se tani shërben si udhërrëfyes dhe shembull jo vetëm për liderët shtetërorë të Kosovës, por për liderët kudo në botë. Edhe lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka bërë homazhe te varri i Rugovës. Ai ka thënë se Rugova është shqiptari më i madh i të gjitha kohëve. Pas homazheve, Abdixhiku ka vizituar edhe familjen e ish-presidentit Rugova. Ai ka thënë se Rugova "na mësoi rëndësinë e unitetit, këmbënguljes dhe miqësisë së përhershme me aleancën euroatlantike dhe botën demokratike, vlera këto që na udhëzojnë e i japin kah rrugëtimit tonë të sotëm". "Sot, në 19-vjetorin e ndarjes nga jeta të presidentit historik të Republikës së Kosovës dr. Ibrahim Rugova, përulemi me respekt e mirënjohje përballë trashëgimisë së tij monumentale, dhe kujtojmë



Demokratike të Kosovës dhe udhëheqës i lëvizjes më të madhe kombëtare për liri, qëndroi si shtyllë e fortë e përpjekjeve tona për një shtet të lirë dhe të barabartë në mesin e familjes euroatlantike", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Abdixhiku ka theksuar se përkushtimi i tij ndaj vendit e popullit të tij e ka shndërruar atë në një simbol ndërkombëtar të rezistencës paqësore. "Vizionar e i palëkundur, ai krijoi platformën politike që udhëhoqi popullin tonë drejt ndërtimit të shtetit. Presidenti Rugova, me veprën e tij unike, na mësoi rëndësinë e unitetit, këmbënguljes dhe miqësisë së përhershme me aleancën euroatlantike dhe botën demokratike, vlera këto që na udhëzojnë e i japin kah rrugëtimit tonë të sotëm drejt të ardhmes me moton: Kosova, shtet i pavarur e sovran, e anëtarësuar në NATO dhe në BE, e me miqësi të përhershme me ShBA-në! Sot, teksa përulemi për të nderuar kujtimin e tij, reflektojmë mbi gjurmët e tij të paslyeshme në historinë e vendit dhe sot, më shumë se kurrë, ndjejmë nevojën për ta mbajtur gjallë frymën e tij në çdo hap që ndërmerim për të ardhmen e Kosovës. Ibrahim Rugova

mbetet figura më e madhe politike e historisë sonë, një simbol i përjetshëm i sakrificës dhe përkushtimit ndaj atdheut. I përjetshëm kujtimi për presidentin historik, Dr. Ibrahim Rugova! Presidenti ka vetëm ditëlindje!", ka shkruar Abdixhiku.

Po ashtu, Rugova është përkujtuar edhe nga përfaqësues të ndryshëm të partive politike, duke përfshirë edhe kryeministrin Albin Kurti dhe liderin e AAK-së, Ramush Haradinaj.

Në 19-vjetorin e vdekjes së Rugovës është hapur një ekspozitë nga fotografi Hazir Reka me fotografitë e ish-presidentit. Po në këtë përvjetor është promovuar libri "Rugova, prijësi intelektual" dhe është paraqitur vetura e restauruar të

cilën e ka përdorur Ibrahim Rugova.

Rugova kishte shërbyer si president i parë i Kosovës dhe ishte lider i partisë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe njihet për rolin e tij në lëvizjen paqësore për pavarësinë e Kosovës nga Serbia gjatë viteve '90.

Nën udhëheqjen e Rugovës, LDK-ja, në bashkëpunim me forcat e tjera politike shqiptare në Kosovë, më 2 korrik të vitit 1990 kishte shpallur Kosovën Republikë dhe më 7 shtator të po të njëjtit vit kishte miratuar edhe Kushtetutën e saj.

Në Kosovën e para luftës ai ishte zgjedhur kryetar i Republikës së Kosovës në zgjedhjet presidenciale, që nuk janë njohur ndërkombëtarisht, të cilat janë mbajtur më 24 maj të vitit 1992 dhe më 22 mars të vitit 1998.

Më vonë Rugova ka fituar edhe në dy garat e përgjithshme zgjedhore të njohura ndërkombëtarisht në Kosovën e pasluftës.

Më 27 gusht të vitit 2005 Rugova kishte udhëtuar për në spitalin ushtarak në bazën amerikane në Landstuhl të Gjermanisë dhe qëndroi aty deri më 3 shtator për trajtim mjekësor. Dy ditë më vonë, më 5 shtator të vitit 2005, presidenti i Kosovës, kishte njoftuar se vuante nga kanceri në mushkëri. Ai vdiq më 21 janar të vitit 2006 në moshën 62-vjeçare.



"kontribut të jashtëzakonshëm në ndërtimin e themeleve të forta të shtetit tonë". "Presidenti Rugova jo vetëm që bëri bashkë të gjithë qytetarët e Kosovës rreth kauzës për liri, pavarësi dhe demokraci, njëkohësisht u bë edhe zëri i Kosovës në botë duke ndërtuar aleanca të rëndësishme që na u deshën më së shumti në ato kohë të vështira", ka thënë Osmani. Ajo

jetën dhe veprën e themeltarit të shtetit të Kosovës dhe prijësit historik të vendit që udhëhoqi popullin tonë drejt lirisë, pavarësisë dhe demokracisë. Më 21 janar të vitit 2006, Kosova humbi arkitektin e saj themeltar, njeriun që me urtësinë dhe vizionin e tij e drejtoi vendin tonë në kohët më të vështira. Ibrahim Rugova, themelues i Lidhjes



Ish-këshilltari juridik i UNMIK-ut në Hagë: Nuk më kujtohet ta kem parë Thaçin duke i dhënë urdhra dikujt

HAGË, 21 JANAR - Ish-këshilltari juridik i UNMIK-ut, Hansjeorg Strohmeier, gjatë dëshmisë së tij në rastin e liderëve të UÇK-së në Hagë, ka mohuar se e ka parë Hashim Thaçin duke dhënë urdhra gjatë kohës sa dëshmitari ishte me misionin e UNMIK-ut këshilltar juridik në Kosovë më 1999. Ai ka pohuar se është e vërtetë të thuhet që ai nuk e kishte parë ndonjëherë Thaçin duke i dhënë urdhra Agim Çekut ose ndonjë prej anëtarëve të UÇK-së apo dikujt tjetër, raporton "Betimi për Drejtësi".

"Nuk më kujtohet. Nuk mund të them as po as jo. Nuk më kujtohet ndonjë rast konkret. Unë të paktën nuk e kam parë që t'i japë urdhra dikujt në praninë time, ndonjë



komandanti apo ndonjë personi. Më janë bërë disa herë pyetje për këtë", ka thënë Strohmeier.

Në një shënim përgatitor të lexuar nga avokati i Thaçit, Luka Mishetiç, pretendohet se

dëshmitari ka thënë se personat që kontaktonte UNMIK-u në atë kohë ishin Thaçin për aspekte politike, ndërsa Agim Çeku për ato ushtarake.

"Ky ishte perceptimi im. Mbj

mend që për aspekte politike duhej t'i drejtohem zotit Thaçi, ndërsa për marrëveshjen dhe për çështje që lidheshin me KPI-në mendonim që duhej t'i drejtohem zotit Çeku ose mendonim që ai ishte personi i kontaktit", ka thënë dëshmitari. Strohmeier ka theksuar se ata e kishin përshtypjen se ka ekzistuar hierarki në UÇK dhe se anëtarët e UNMIK-ut do të thoshin se përgjegjës ishte Thaçi.

"Sipas nesh, ose mënyra se si e kishim kuptuar ne, ndonëse nuk e kishim shprehur mendimet se ka pasur një hierarki. Ka ekzistuar një hierarki. Për shembull nëse do të pyesni personat në UNMIK

se kush janë personat përgjegjës në UÇK, të gjithë do të thoshin zoti Thaçi", ka thënë Strohmeier.

Fjala e tij është ndërprerë nga avokati Mishetiç, duke i thënë se nuk u interesojnë anketat. Ndërsa për pyetjet e fundit Mishetiç ka kërkuar seancë private, e cila është aprovuar nga trupi gjyqësor.

Më tutje, dëshmitari ka thënë se nuk i kujtohet që është takuar ose ka biseduar ndonjëherë me Kadri Veselin dhe se nuk e di se cili ka qenë roli i Rexhep Selimit gjatë vitit 1999.

"Unë flas vetëm për vete, por mua personalisht nuk më kujtohet asnjë rast që jam takuar me zotin Veseli", ka thënë Strohmeier.

Super të pasurit po pasurohen edhe më shumë

Berlin, 21 janar - Njerëzit më të pasur në botë po bëhen gjithnjë e më të pasur. Pasuria e tyre rritet deri në 100 milionë dollarë në ditë. Në anën tjetër, shtohet varfëria. Në prag të Forumit Ekonomik Botëror në Davos, "Oxfam"-i ka njoftuar se vitin e kaluar numri i miliardërëve në botë është shtuar me 204 miliardër të rinj. "Oxfam"-i ka bërë me dije se pasuria e super të pasurve po rritet: pasuria e tyre totale është rritur nga 13 trilionë dollarë në 15 trilionë dollarë në vitin 2024, brenda një viti. Në të kundërt, 733 milionë njerëz nuk kanë ushqim të mjaftueshëm – rreth 152 milionë më shumë se në vitin 2019.

Studimi i "Oxfam"-it "Takers not Makers" ka zbuluar se aktualisht ka 2 769 miliardër në botë. Pasuria e tyre është rritur tri herë më shpejt në vitin 2024 krahasuar me një vit më parë, me rreth 100 milionë dollarë në ditë.

Në Gjermani ka 130 miliardër

Në Gjermani pasuria totale e super të pasurve është rritur me 26.8 miliardë dollarë në vitin 2024, në gjithsej 625.4 miliardë dollarë. Janë regjistruar edhe nëntë miliardër të rinj, kështu që tani ka 130 miliardër në Gjermani. Gjermania ka tani më së shumti miliardër pas ShBA-së, Kinës dhe Indisë. "Oxfam"-i llogarit se miliardëret gjermanë përfitojnë mbi mesataren nga trashëgimia, ndërsa 36 për qind e pasurisë së miliardërëve në mbarë botën vjen nga trashëgimia, në Gjermani kjo shifër shkon në 71 për qind. Në të njëjtën kohë, varfëria është rritur ndjeshëm vitet e fundit. Shumë njerëz nuk janë në gjendje ta ruajnë standardin e tyre të zakonshëm



të jetesës. "Kjo pabarazi ekstreme është shkaktuar kryesisht nga politikat e padrejta tatimore", ka shpjeguar zëdhënësi i "Oxfam"-it, Manuel Schmitt. "Super të pasurit shpesh paguajnë më pak taksa dhe kontribute sesa familjet e klasës së mesme", thotë ai.

"Oxfam"-i: Kërcënimet për demokracinë

Sipas autorëve të studimit, të pasurit janë përfituesit më të mëdhenj të viteve të krizës. Nga këndvështrimi i kësaj organizate humanitare, hendeku në rritje ka pasoja për gjendjen globale, por edhe për

gjendjen në shoqëritë kombëtare. Super të pasurit kanë siguruar me qëllim që strukturat e padrejta të mbeten të qëndrueshme. "Vendet ekonomikisht të forta në veriun global vazhdojnë të vendosin rregulla, nga të cilat përfitojnë super të pasurit dhe korporatat e tyre", është thënë në raport. Kjo, thotë studimi, është ende pasojë e kolonializmit. Drejtori ekzekutiv i "Oxfam"-it në Gjermani, Serap Altinisik, ka paralajmëruar për pasoja negative për demokracinë. "Pasuria shkon paralelisht me pushtetin politik. Këtë e shohim sot me rastin e rikthimit të presidentit Donald Trump: një president miliardër i

mbështetur nga njeriu më i pasur në botë, Elon Musk", ka thënë Altinisik, duke shtuar se "rritja e pasurisë së super të pasurve është e pakufizuar, ndërkohë që vështirë se ka përparim në luftën kundër varfërisë".

Sipërmarrësit amerikanë të teknologjisë në krye

Raporti bazohet në të dhënat e revistës "Forbes". "Edhe sikur të humbnin 99 për qind të pasurisë së tyre brenda natës, ata do të ishin ende miliardër", është thënë në raportet e "Forbes", ku përfshihen edhe sipërmarrësit amerikanë të teknologjisë, Jeff

Bezos (Amazon), Mark Zuckerberg (Meta), Larry Ellison (Oracle), Bill Gates dhe Steve Ballmer (të dy Microsoft) dhe Larry Page (Google). Besohet se super të pasurit kanë ndikim në rritje mbi legjislacionin tatimor. Për shembull, në uljen e tatimit mbi të ardhurat e korporatave, tatimet joadekuate të fitimeve kapitale, përjashtimin nga tatimi mbi trashëgiminë dhe heqjen e tatimit mbi pasurinë. "Midis viteve 1990 dhe 2017, numri i vendeve me taksë mbi vlerën e shtuar u trefishua nga 50 në më shumë se 150, ndërsa numri i vendeve me një taksë neto mbi pasurinë ka rënë nga dymbëdhjetë në katër", ka thënë studimi i "Oxfam"-it. /DW

Ministri Murati thotë se Kosova ka pasur inflacion më të ulët në vitin 2024

PRISHTINË, 21 JANAR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se Kosova ka pasur inflacion më të ulët në vitin 2024. Ai ka bërë me dije se shkalla mesatare e inflacionit në vitin 2024 në Kosovë ka qenë 1.6 për qind sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), duke thënë se kjo e bën Kosovën vendin me shkallën më të ulët të inflacionit nga të gjitha shtetet e rajonit. "Shkalla mesatare e inflacionit për vitin 2024 në Kosovë ka shënuar 1.6 %, sipas ASK-së. Kjo njëkohësisht e bën Kosovën vendin me shkallën më të ulët të inflacionit nga të gjitha shtetet e rajonit. Inflacioni ka goditur të gjitha vendet e botës vitet e fundit,



por falë masave të ndërmarra nga qeveria, Kosova qëndron më mirë sesa rajoni", ka shkruar Murati në "Facebook". Ministri ka thënë se Kosova tani qëndron më së miri sesa rajoni falë masave të

ndërmarra nga qeveria. Madje ai ka përmendur disa subvencione që ka bërë qeveria Kurti. "Kemi subvencionuar energjinë elektrike, për ta mbajtur çmimin të përbalueshëm, dhe kjo ka ndikuar që të

parandalohet rritja e mëtotjeshe edhe për produktet e tjera që prodhohen në vend. Sepse kur shtrenjtohet energjia elektrike si input në proces prodhimi, patjetër që shtrenjtohet edhe produkti final. E prodhuesit në Kosovë vazhdojnë ta kenë koston më të lirë të energjisë elektrike në rajon. Kemi rritur subvencionet në bujqësi, që të kemi stabilitet më të lartë e të mos varemi kryekëput nga çmimet e importit. Kemi subvencionuar prodhuesit për t'i shtuar kapacitetet prodhuese, dhe kemi mbështetur të gjitha bizneset përmes Superpunës, duke ua lehtësuar koston e marrjes së punëtorëve të rinj. Kemi

rritur pagat në sektorin publik për 46.5 % mesatarisht prejse e kemi marrë mandatin, dhe kemi rritur pagën minimale pas më shumë se një dekadë në 350 euro. Kemi rritur pensionet fillimisht duke u siguruar që asnjë pension të mos jetë nën 100 euro, kemi ndarë pesë herë radhazi shtesën e njëhershme prej 100 eurosh, dhe kemi rritur pensionet edhe për 20 % të tjera. Kemi nisur skemën e shtesave për fëmijë dhe nëna lehonë, dhe kemi vazhduar rritjen e shtesave në vitin e kaluar. Gjithsej 150 milionë euro shtesë gjatë vitit u shkojnë të gjitha familjeve të Kosovës që kanë fëmijë", ka shkruar Murati.

Kthimi i palestinezëve, mes hidhërimeve e rrënojave



Ka flamuj, të grisur e të ndotur, por që valviten me krenari dhe më në fund me shpresë. Të shtënat janë «në ajër, për të festuar, jo për të vrarë». Disa përkëdhelin idenë normale të një kafeje dhe një cigareje, një ëndërr e pamundur në Rripin e Gazës, ku prej më shumë se një viti mungon gjithçka, madje edhe uji i pijshëm.

Ka nga ata që kanë paketuar ato pak sende të ruajtura për muaj të tërë nën një çadër gjithnjë e më shumë të arnuar, për t'u kthyer sa më shpejt. «Dua të shkoj në qytetin e Gazës, të shoh çfarë ka mbetur nga shtëpia ime, nga familja ime. Kush është ende gjallë, do të kthehet aty», thotë dikush. Nuk është vetëm.

Pak minuta pas armëpushimit, rrjetet sociale mbushen me pamje të një turme që ecën mes rrënojave, marshon mes shtyllave të thyera, ndërtesave të shkatërruara që kush e di sa trupa fshehin, lagjeve të tëra

të bëra pluhur e hi dhe të shndërruara në qefinë. Të gjithë përpiqen të arrijnë në shtëpinë që vetëm mund ta kishin imagjinuar, duke pyetur: «A është ende në këmbë?».

Pas pesëmbëdhjetë muajsh sulmesh, humbjesh, frike dhe urre, është dita e shpresës në Gaza. Të qëndrosh dhe të rindërtosh, të largohesh dhe të lësh gjithçka pas, kjo është zgjedhja.

Hassan Ashour humbi shtëpinë gjatë luftës dhe tani jeton në Deir el Balah me gruan dhe dy fëmijët. Për të, në Gaza nuk ka më asgjë. «Kam nevojë për të paktën një vit jashtë Rripit të Gazës», thotë ai. Për të dhe për të tjerë, shpresa quhet Rafah, pika kufitare që deri në majin e vitit të kaluar ishte rruga e fundit e sigurt për të plagosurit, të sëmurët rëndë apo për ata të paktë që mund të paguanin shërbimet e shtrenjta të rrjetit Hala.

Që nga dje, portat e zeza me dekorime të arta, të blinduara

që nga maji i kaluar kur Izraeli mori kontrollin e zonës, janë hapur sërish. Kjo nuk do të thotë që kushdo mund të largohet nga Gaza, pasi asnjë nga vendet fqinje, duke filluar nga Egjipti, nuk e dëshiron një eksod. Por fakti që kjo portë është bërë sërish funksionale mund të nënkuptojë fundin e urisë. Vetëm gjatë ditës së djeshme, aty kaluan 310 kamionë me ndihma dhe 20 me karburant. «Janë pothuaj 4 mijë gati», njofton UNRWA.

Ahmed kalon kufirin e Rafahut me kamionin bosh, me borinë që bie dhe një krah jashtë që tregon simbolin e fitores. Sapo ka shkarkuar qindra thasë me miell, që – nëse inspektimet e lejojnë – do të hyjnë në Rafah. Dhe kjo tashmë duket si një mrekulli, sepse nuk ka ndodhur prej muajsh.

Në Rafah, makineria e përgatitjeve u ndal, në Sinain e militarizuar kontrollet filluan të zgjasnin me orë të tëra. E megjithatë gjithçka

dukej gati. Që nga agimi i së dielës, ushtarët e IDF kishin filluar të tërhiqeshin nga qendra e Rafahut, deri dy kilometra drejt korridorit Filadelfi, përgjatë kufirit me Egjiptin. Për herë të parë pas 261 ditësh, 50 ambulanca kishin hyrë në Gaza nga Rafahu. Pastaj gjithçka u bllokua dhe në Rrip rifilluan sulmet, me tragjedinë e tyre. Në orën 11:15 erdhi kthesa, kur të gjithë ishin të sigurt për dështimin e radhës. Dhe ja portat që hapen, kamionët që ndezin motorët. «E kam marrë këtë ngarkesë patatesh njëzet ditë më parë – thotë Mohamed. Kisha frikë se do të ndodhte si në maj, kur na bënë të prisnim aq gjatë sa na u desh t'i hidhnim të gjitha». Muajt e kaluar kjo ndodhte rregullisht, ndërsa disa kilometra larg njerëzit vdisnin nga uria. Në Gaza sot nevojitet gjithçka. Pjesa më e madhe e popullsisë është e keqshqyer, më pak se gjysma e 36 spitaleve të Gazës janë funksionale. Deri në



armëpushim – llogarit Save the Children – 15 fëmijë në ditë kanë pësuar dëmtime të rënda ose të përhershme.

Edhe për ta Rafahu mund të jetë një shpresë. Sipas marrëveshjes, nga porta egjiptiane duhet të dalin gratë dhe fëmijët e plagosur, për t'u dërguar fillimisht në qendrën e triazhit të ngritur afër pikës kufitare dhe më pas të shpërndarë në spitalet e Sinait. Por deri në pasditen e vonë dje, askush nuk ishte transferuar. As civilë, as «personeli ushtarak i plagosur».

Sipas burimeve, secili prej tyre duhet të shoqërohej nga tre anëtarë të familjes dhe sa më shpejt të drejtohej në spitalet e Dohës. Kjo është një nga pikat më të paqarta të tekstit përfundimtar të marrëveshjes, ndoshta më e ndërlikuara për Izraelin. «Një pasaportë për Hamasin» shprehen me hidhërim disa, mina e radhës që mund të shkatërrojë armëpushimin e brishtë. / bota.al

EURO GLASS
SAINT-DENISAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

FC Liria liron nga detyra trajnerin Bledar Devolli

FC Liria ka ndarë rrugët me trajnerin Bledar Devolli. Klubi prizrenas e ka liru nga detyra trajnerin nga Shqipëria, derisa e ka falënderuar për kontributin e dhënë në klub.

“Klubi FC Liria njofton se trajneri Bledar Devolli është liru nga detyra. Si një qytet me traditë dhe kulturë, Liria duhet të respektohet si brenda ashtu edhe jashtë fushës.

Synimet e klubit janë të qarta dhe do të vazhdojmë së bashku drejt suksesit! Falënderojmë trajnerin Devolli për angazhimin dhe kontributin e dhënë gjatë kohës që ishte

pjesë e klubit dhe i urojmë suksese në të ardhmen. FC Liria vazhdon përpara me të njëjtin përkushtim dhe ambicie për t'i arritur objektivat tona”, thuhet në njoftim e Lirisë.



Sot dy ndeshje në Superligë, dy të tjera nesër



Mesjava sjell superpërballje në ProCredit Superligën e Kosovës në basketboll, ku zhvillohet xhironja e 18. Të mërkurën do të përballen Bashkimi me Borën në një sfidë të rëndësishme. Prizrenasit kanë 12 fitore dhe pesë humbje, ndërsa e kundërta është me prishtinasit që kanë pesë fitore e 12 humbje. Sfidë mjaft interesante është të mërkurën ndërmjet dy skuadrave verdhezi, ish-kampionëve të Kosovës, Pejës dhe Golden Eagle Yllit. Pejanët kanë dhjetë fitore dhe shtatë humbje, derisa e kundërta me therandasit me shtatë fitore dhe dhjetë humbje. Të enjten

zhvillohet kryendeshja e kësaj jave në mes të rivalëve të vjetër në basketbollin e Kosovës, Trepçës dhe Sigal Prishtinës. Takimet mes këtyre dy skuadrave gjithmonë kanë qenë interesante dhe kështu pritet edhe të enjten mbrëma në “Minatori”. “Xehetarët” kanë 12 fitore e pesë humbje, ndërsa prishtinasit nëntë fitore e tetë humbje. Këto dy skuadra u përballën mesjavën e kaluar për Kupë, ku bardhekaltrit fituan 67:65 në gjysmëfinale, derisa sfida e kthimit do të zhvillohet mesjavën e ardhshme, ku do të vendoset se kush do të kualifikohet në finale.

Vëllaznimi në top formë do të ndeshet me Proton Cable Prizrenin. Kuqezinjtë kanë nëntë fitore e tetë humbje, derisa prizrenasit janë në vendin e tetë me katër fitore e 13 humbje.

PROCREDIT SUPERLIGA - JAVA 18

Të mërkurën takohen:
18:30 Bashkimi - Bora
18:30 Peja - Golden Eagle Ylli

Të enjten takohen:
18:30 Trepça - Sigal Prishtina
18:30 Vëllaznimi - Proton Cable Prizreni

SHKURT

Dalin në shitje biletat për ndeshjen Angli - Shqipëri

Kombëtarja e Shqipërisë do ta nisë edicionin kualifikues për Kupën e Botës 2026 më 21 mars ndaj Anglisë në stadiumin “Wembley” në Londër. Departamenti i Komunikimit në FShF bën me dije se biletat për ndeshjen Angli - Shqipëri kanë dalë në shitje. Çmimet e biletave: Biletat janë të ndara në tri kategori dhe çmimet ndryshojnë sipas vendndodhjes në stadium. Tifozët shqiptarë kanë në dispozicion sektorët 126, 127, 128, 129, 130, 131 dhe 132.

Themelohet Shoqata e Basketbollistëve dhe Basketbollisteve të Kosovës, Dardan Berisha zgjidhet kryetar

Për herë të parë është themeluar Shoqata e Basketbollistëve dhe Basketbollisteve të Kosovës. Në mbledhjen e mbajtur në zyrat e Federatës së Basketbollit të Kosovës kanë marrë pjesë 35 delegatë, apo lojtarë dhe lojtare, të cilët janë pjesë e rëndësishme e basketbollit të Kosovës. Kapiteni i Kosovës, Dardan Berisha, ka qenë i vetmi kandidat dhe me 35 vota për është zgjedhur kryetar i Shoqatës së Basketbollistëve dhe Basketbollisteve të Kosovës. Kjo Shoqatë do të ketë përfaqësuesit e saj në Bordin e FBK-së. Shoqata është themeluar konform Ligjit të ri të Sportit. Po ashtu, janë zgjidhur edhe anëtarët e Bordit të Shoqatës, të cilët janë: Gëzim Morina, Arbnore Përçuku, Aulona Muhadri, Erjon Kastrati, Drilon Hajrizi dhe Fisnik Rugova. Shoqata synon t'i mbrojë të drejtat e basketbollistëve/eve në Kosovë dhe të jetë zëri i tyre.

Lille kërkon 25 milionë euro për Zhegrovën

Edon Zhegrova së shpejti mund të largohet nga Franca për ta vazhduar karrierën diku tjetër. Zhegrova i cili këtë sezon ka qenë autor i katër golave në 12 ndeshje në kampionat, po tërheq interesim të fortë nga Napoli. Sipas gazetarit Sacha Tolivieri, Zhegrova nuk ka qëndruar indiferent ndaj këtij interesimi dhe ka shprehur vullnetin e tij që t'i bashkohet gjigantit italian. Te Lille në anën tjetër janë të vetëdijshëm se 25-vjeçari nuk do ta rinovojë kontratën e cila skadon në vitin 2026 dhe për këtë arsye i ka vënë një çmim prej 25 milionë eurosh. Sidoqoftë, kjo shumë po konsiderohet tejet e lartë nga Napoli, të cilët tashmë kanë filluar të eksplorojnë opsione të tjera me kosto më të ulët. Kujtojmë se Zhegrova është pjesë e Lilles që nga janari i 2022-s, kur iu bashkua atyre nga Baseli për shtatë milionë euro.

Batatina dënohet për kanosje ndaj gjyqtarit Nuza

Prishtinë, 21 janar - Gjykata Themelore në Prishtinë e ka dënuar me gjobë trajnerin e Llapit, Tahir Batatinën, për veprën penale “kanosje” ndaj gjyqtarit Genc Nuzës. Batatina, sipas gjykatës, e ka kanosur Nuzën më 31 gusht, pas ndeshjes Prishtina - Llapi, duke e ofenduar si shenjë pakënaqësie me rezultatin e ndeshjes. “Do ta shohësh nga

sot se a do të gjykosësh më ndeshje të futbollit, do të kesh punë me mua personalisht, vetëm në qoftë se vdes do të shpëtosh”, i është drejtuar Batatina, Nuzës, sipas gjykatës. Më tej, gjykata tha se nëse dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet, dënimin e njëjtë do ta ekzekutojë duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 euro të

gjobës. Për dënimin ndaj Batatinës ka reaguar edhe gjyqtari Nuza, i cili tha se, pavarësisht prej dënimeve që shqiptojnë organet e drejtësisë, ai për çdo sulm, kërcënim, akuzë dhe shpifje do t'u drejtohet organeve të drejtësisë. “Pasi kam bërë denoncim për kanosje si gjyqtar kryesor në ndeshjen e Albi Mall Superligës në Futboll,

e zhvilluar më 31.08.2024 në stadiumin ‘Fadil Vokrri’ ndërmjet Prishtinës dhe Llapit, sot më 21.01.2025 kam pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë aktgjykimin si palë e dëmtuar. Gjykata e ka cilësuar fajtor personin që e ka kryer veprën penale të kanosjes ndaj meje gjatë ushtrimit të detyrës sime zyrtare si gjyqtar futbollit”, ka shkruar Nuza.



Lara Colturi shkëlqen në pistën italiane, renditet e katërta në garën e sllallomit gjigant

TIRANË, 21 JANAR - Në pistën italiane të Kronplatz u zhvillua sot gara e radhës e Kupës së Botës për femra në ski, ajo e disiplinës së sllallomit gjigant. Në këtë garë garoi për Shqipërinë edhe skiatorja Lara Colturi. Skiatorja kuqezi bëri një tjetër paraqitje shumë të mirë,

duke u renditur në vendin e katërt. Në përfundim të dy zbritjeve ajo mbeti jashtë podiumit për pak të mijtat, duke dhënë kohën e përgjithshme 1'56"50. Pas zbritjes së parë, Colturi u kualifikua në vendin e tetë, me kohën 57"00. Ndërsa në zbritjen

e dytë, skiatorja kuqezi ndali kronometrin në kohën 59"50, duke fituar disa pozicione në klasifikim. Pas dy vendeve të dyta të arritura këtë sezon, Colturi siguron një vend të pestë, duke qenë gjithnjë mes skiatoreve më të mira. Paraqitja e shkëlqyer e skiatores 18-

vjeçare është mjaft premtuese për të ardhmen. Colturi gjithnjë ka arritur ta kalojë me sukses zbritjen e parë këtë sezon, duke hyrë mes skiatoreve që konkurrojnë për podiumin apo renditje. Këtë gjë e konfirmoi gara e sotme, ku ajo sërish ishte mes më të mirave.



Messi pyetet për Kupën e Botës 2026: Sapo e kam filluar vitin, ndihem i motivuar dhe i emocionuar

MIAMI, 21 JANAR - Lionel Messi, fitues i Kupës së Botës 2022 me Argentinën dhe një nga futbollistët më të mëdhenj në histori, ka komentuar mundësinë e pjesëmarrjes së tij në Botërorin 2026. Në një deklaratë të fundit, Messi ka ndarë emocionet dhe motivimin që ndien për sezonin e ri, duke lënë të hapur mundësinë e një tjetër Botërori në karrierën e vet: "Kupa e Botës 2026? Unë sapo e kam filluar vitin. Siç them gjithmonë, sinqerisht, e kam nisur 2025 me një ndjenjë shumë të madhe emocioni dhe motivimi". Deklarata e tij tregon se ylli argjentinas është i fokusuar në sezonin aktual, por nuk përjashton një tjetër kapitull në karrierën e tij ndërkombëtare. Për Messin, pjesëmarrja në Kupën e Botës 2026, që do të zhvillohet në ShBA, Meksikë dhe Kanada, mund të jetë një sfidë e rëndësishme, veçanërisht duke marrë parasysh moshën e tij. Në atë kohë, Messi do të jetë 39 vjeç, por përvoja dhe aftësitë e tij e



bëjnë ende një lojtar kyç për kombëtaren argjentinase. Pas suksesit historik në "Katar 2022", ku Argjentina fitoi Kupën e Botës, pas një pauze prej 36 vitesh të Albiceleste, 8 herë fituesi i "Topit të Artë" u shpreh se ishte çasti më kulminant i karrierës së tij. Edhe pse kishte deklaruar se ky trofe ishte ëndrra e tij më e madhe, pas triumfit në Katar, shumë tifozë dhe ekspertë kanë shprehur që Messi të vazhdojë ta përfaqësojë Argentinën në nivelet më të larta. Aktualisht Messi luan tek

Inter Miami në MLS, ku ka fituar "Leagues Cup" dhe ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e interesit për futbollin në ShBA. Forma e tij fizike dhe energjia që shfaq në fushë tregojnë se ka ende shumë për të dhënë. Tifozët argjentinas dhe ata të futbollit në mbarë botën do të presin me padurim vendimin e tij për pjesëmarrjen në Botërorin e ardhshëm, i cili mund të jetë një lamtumirë madhështore për një nga lojtarët më të mëdhenj që ka parë futbollin ndonjëherë.

SHKURT

Asllani në formacionin e javës në Serinë A

Kristjan Asllani u është përgjigjur kritikëve në mënyrën më të mirë të mundshme. Ylli i Kombëtares shqiptare nuk po kalonte çaste aq të mira me Interin, por që riktheu gjithçka në të mirë të tij në fundjavën që shkoi. Në fakt, mesfushori kreativ shkëlqeu në fitoren e "NERAZZURRËVE" në fitoren 3:1 ndaj Empolit. E kjo bëri që ai të përfshihet në formacionin e javës nga faqja e specializuar për statistika "Sofascore" për javën e 21-të në Serinë A. 22-vjeçari u vlerësua me notën 8.3 dhe tash e tutje synon të bëhet protagonist i kampionëve të Italisë. Trajneri Simone Inzaghi e ka besimin e plotë në përfaqësuesin shqiptar, të cilit ia jep rastin kohë pas kohe, por që e konsideron atë si një lojtar të rëndësishëm për ekipin zikaltër.

Hamiltoni nuk fsheh emocionet: Realizova ëndrrën

Etapë e re në horizont për Lewis Hamiltonin. Piloti britanik, pas 13 vitesh te Mercedesi, ka kaluar te Ferrari. Hamiltoni së fundmi nuk ka hezituar të bëjë një postim në rrjetet sociale. "Janë disa ditë që e di se do t'i mbash mend gjithë jetën dhe sot, dita ime e parë si ngasës i Ferrarit, është prej atyre ditëve". "Isha mjaftueshëm me fat për të realizuar gjëra në karrierën time që mendoja se ishin të pamundura, por një pjesë e imja është mbajtur gjithmonë pas asaj ëndrrë për të garuar me ngjyrën e kuqe. Nuk mund të jem më i lumtur që e realizoj këtë ëndërr sot. Sot po e fillojmë një epokë të re në histori të këtij ekipi ikonik dhe mezi pres të shoh se çfarë rrëfimi do të shkruajmë së bashku", ka shkruar Hamiltoni.

Vitor Reis, lojtar i ri i Manchester Cityt

Klubi anglez Manchester City ka konfirmuar zyrtarisht transferimin e qendërmbrojtësit Vitor Reis nga Palmeiras. Qytetarët kanë zyrtarizuar brenda 48 orëve edhe transferimin e dytë në afatin kalimtar të dimrit. Pas transferimit të Abdukodir Khusanov nga Lensi, City ka konfirmuar edhe transferimin e Reis nga Palmeiras. Është faqja zyrtare e kampionit të Ligës Premier që ka konfirmuar nënshkrimin me 19-vjeçarin, i cili thuhet t'i ketë kushtuar 35 milionë euro. "Manchester City është i kënaqur të njoftojë për nënshkrimin e Vitor Reis nga Palmeiras". "Reprezentuesi i ri brazilian 19-vjeçar transferohet në 'Etihad Stadium' me një marrëveshje katërvjeçare e gjysmë, duke e mbajtur atë në City deri në verën e vitit 2029", thuhet në njoftim.

Bostoni, 'leksion' rivalëve të Golden States, Clevelandit triumfon ndaj Phoenixit



San Francisco, 21 janar - Skuadra kampione e Bostonit fitoi me rezultat 125-85 në fushën e Golden States, duke konsoliduar vendin e dytë në Lindje. Ndeshje e komanduar nga miqtë, ku vendimtar ishte stoli, nga erdhën 50 pikë (Tatum me 22 pikë më i miri). Në krye të

renditjes në Konferencën e Lindjes qëndron Clevelandit, që mundi me shifrat 118-92 Phoenixin. Donovan Mitchell me 33 pikë ishte lider për Cavaliersin. Surprizon Charlotte, që falë një loje të mirë kolektive (6 lojtare realizuan mbi 10 pikë), mundi me rezultat 110-

105 Dallasin (Irvingu, 33 pikë). Jashtë fushe fitoi ekipi i Chicagos, që mundi me rezultat 112-99 Clippersat. Zach LaVine me 35 pikë bëri dallimin në fushë për Bulls. Fitore në sekondën e fundit për Memphisin, që mundi me rezultat 108-106 Minnesotan (Jared Jackson 24 pikë).

REZULTATET

Charlotte - Dallas	110-105
Houston - Detroit	96-107
Memphis - Minnesota	108-106
New York - Atlanta	119-110
Cleveland - Phoenix	118-92
Golden State - Boston	85-125
New Orleans - Utah Jazz	12-119
Clippers - Chicago	99-112

Mbappe: Të jesh në Real Madrid, gjithmonë një ëndërr

Sulmuesi i Real Madridit, Kylian Mbappe, ka shprehur kënaqësinë e tij për të luajtur për gjigantët spanjollë, duke e përshkruar përvojën e tij si një "ëndërr" të realizuar. Mbappe, i cili ka qenë në

formë mbresëlënëse kohët e fundit, duke përfshirë dy gola kundër Las Palmas, zbuloi se i pëlqen presioni për të performuar në nivelin më të lartë. "Të jesh këtu në Madrid është gjithmonë një ëndërr. Sa

herë që kam mundësinë të luaj këtu ndihem i lumtur", ka thënë Mbappe. "Edhe kur nuk luaja mirë, ishte faji im, i askujt tjetër dhe tani jam më mirë". Mbappe, gjithashtu, theksoi nevojën e tij për

presionin intensiv që vjen me të luajturit për një klub si Real Madrid. "Kërkesat e Real Madridit? Më duhet. Më duhet të ndiej se gjithmonë duhet të bëj më shumë", ka përfunduar

francezi. Komentet e yllit francez vijnë pas paraqitjes së tij të spikatur kundër Las Palmasit, ku ai shënoi dy gola për ta ndihmuar Real Madridin të sigurojë një fitore 4-1.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 198/1
Dt: 21.01.2025

Në bazë të nenit 95, 96 dhe 97 të Ligjit për Zyrtar Publik, neni 8 i Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Neni 13 dhe 34 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional nr.04/L-138, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), neni 5 dhe 6 të Rregullorës (QRK) nr. 27/2024 për Procedurat Konkurrimit për Nëpunësit Administrativ dhe Mbështetës, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita	Vendi lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitive
QeK	Qendra e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi", në Prishtinë	Prishtinë	Dy (2) Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e	Vendi lirë	2

Titulli i pozitës së punës: Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e

Klasa/ Koeficienti: I23-3.76

Kohëzgjatja e kontratës: Në kohë të pacaktuar

Orari: 40 orë pune në javë

Detyrat dhe Përgjegjësitë kryesore për pozitën: Nëpunës/e teknik/e dhe mbështetës/e

- Bën mirëmbajtjen e pastërtisë së gjithë objektit shkollor;
- Kujdeset për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore;
- Ndihmon stafin në rregullimin e orendive të shkollës dhe në realizimin e punëve teknike;
- Merr pjesë në rregullimin e hapësirave të jashtme shkollore, si dhe punë tjera të cilat i ndan drejtori i shkollës.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për këtë vend pune

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të zotërojë të paktën njëerë nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diploma e shkollës e mesme;
- Kopjen e dëshmisë së përvojës së punës (nëse ka përvojë);
- Të ketë shkathtësi pune të pavaruar dhe në ekip;

Dokumente që kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Formulari i aplikimit (merret dhe dorëzohet në Qendrën e Kompetencës për të cilën është shpallur konkursi)
- Rezymeja personale (CV)
- Dokumenti personal (kopje të letërnjoftimit ose pasaportës)
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat të noterizuara)
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (sjellet nga kandidati pas përzgjedhjes, para nënshkrimit të kontratës)
- Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

- Vlerësimi i jetëshkrimit - CV (deri në 30 pikë)
- Intervita me gojë (deri në 70 pikë)

Mënyra e njoftimit me rezultatet:

- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë me gojë, si dhe orari i intervistave do të njoftohen me e-mail dhe përmes telefonit.
- Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do tu dërgohen kandidatëve me e-mail dhe do të shpallen në tabelën e shpalljeve në shkollë dhe në <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes nga data 22.01.2025 deri me datën 05.02.2025. Aplikacionet duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucionit në të cilin është shpallur konkursi gjegjësisht në Qendrën e Kompetencës "Shtjefen Gjeçovi".

Sqarime shtesë:

- Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);
- Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publikë;
- Aplikacionet e pakompletuara, mosplotësimet e sakta dhe të qarta të formularit të aplikimit dhe ato që dorëzohen jashtë afatit zyrtar të përcaktuar në këtë konkurs nuk do të shqyrtohen.



Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. - 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net | kuzhinaqendrore@gmail.com | tel: + 383 45 709 106

Njoftim për ftesë për ofertë / Shprehje Interesi
Ndërmarrja Publike Lokale "Ku'zina" Sh.A.**Për marrje të objektit me qira**

Ndërmarrja Publike Lokale "Ku'zina" Sh.A. fton të gjithë të interesuarit për paraqitjen e ofertave për dhënie me qira të objekteve afariste sipas kushteve të mëposhtme:

Kërkesat:

- Objektet potenciale** duhet të identifikohen, shqyrtohen dhe të vlerësohen për përputhshmërinë e tyre me kushtet për funksionimin e ndërmarrjes.
- Sipërfaqja minimale e kërkuar:** Objekti duhet të ketë të paktën 1200 m² për të plotësuar nevojat operacionale të ndërmarrjes
- Vendndodhja:** Objektet duhet të ndodhen brenda një perimetri prej 7 km nga vendndodhja e ndërmarrjes aktuale.

Dorëzimi i ofertave:

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertat në pliko të mbyllur, të shoqëruara me dokumentacionin e nevojshëm mbi pronësinë dhe specifikacionet teknike, në selinë e **Ndërmarrjes Publike Lokale "Ku'zina" sh. a.**, rr. Egnatia, Lagja Ulpianë, Prishtinë.

Afati për dorëzimin e ofertave është **deri më datën 27 Janar 2025, ora 16:00**. Ofertat e pranuar pas kësaj date nuk do të merren parasysh.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Dokumentet e nevojshme mbi pronësinë e ofertuesit.
- Prezantim i shkurtër i objektit të ofruar për qiramarrje (përfshirë fotografitë përkatëse, specifikacionin teknik - planimetrinë e objektit);
- Çmimi i ofertuar për qira mujore;

Afati i qirasë:

Ofertuesit të suksesshëm do t'i ofrohet kontratë qiraje për një periudhë **dhjetë (10) vjeçare**, me mundësi vazhdimi me kusht të pajtimit të dyanshëm.

Për informata të tjera apo për specifikimet teknike të kërkuara, mund të kontaktoni në adresën elektronike:

kuzhinaqendrore@gmail.com

NPL "Ku'zina" sh. a. mban të drejtën të kërkojë informata dhe dokumente shtesë nga ofertuesit që do të shprehin interesimin e tyre.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 8 par. 4, nenit 11, nenit 21 nën par. 2.2 dhe nenit 25 të Rregullores Nr. 55/21 për Marrëdhënien e Punës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. në Vushtri e miratuar me datë 21.12.2021 nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A., e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 94/25 të datës 21.01.2025 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A, me datë 21.01.2025 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve

Numri i ekzekutuesve: 3

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Koeficienti i pagës: 390.00 Euro Bruto

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga epriori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të epriorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së epriorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njësive të Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

> Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

> Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

> Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

> Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 22.01.2025 deri me datë 05.02.2024 në ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 12.02.2025.
- Afati për ankesë nga data 13.02.2025 deri me datë 18.02.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 28.02.2025.

- Afati për ankesë nga data 03.03.2025 deri me datë 05.03.2025.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 12.03.2025.
- Afati për ankesë nga data 13.03.2025 deri me datë 17.03.2025.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatit e suksesshëm është më së largu 24.03.2025.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

> Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: hrperparimi@gmail.com.

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

> Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e njëjtinë përfshijnë edhe gjininë tjetër.

> Përfundim

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- "Lentii" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 810197922, si dhe certifikatën e TVSH-së me nr. 330311655.

- Erodita Lleshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi".

- Gjon Tuci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës "Gjergj Fishta" Bishtazhin.

- Egzon Nagavci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës "Emin Duraku".

- Edonis Makshana shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë dhe njëmbëdhjetë të shkollës së mesme "Selajdin Mullaabazi Mici" Rahovec.

- Alban Jollaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore klasa IX.

- Valdita Elezaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - Bll shfmu "Pjeter Budi" Lubizhd e Hasit.

- Kasum Cocaj shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.

- Violeta Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar,

lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



U prilog članu 8, članu 10 pod st. 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, i član 8. st. 4, član 11, član 21 pod st. 2.2 i član 25 Uredbe br. 55/21 o radnim odnosima NPL "Progres" Sh. A. u Vučitrnu odobreno 21.12.2021 od strane Borda direktora NPL "Përpلامي" Sh. A., a na osnovu rješenja br. protokola 274/25 od 21.01.2025. godine glavnog izvršnog direktora, NPL "Përpلامي" Sh. A od 21.01.2025 saopštava:

JAVNI KONKURS

I. Naslov: Čistač kancelarija i objekata

Broj izvršilaca: 3

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje termina: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.

Stručna priprema: Osnovna škola

radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo

Izveštava: Rukovodioci Jedinice za održavanje - Čišćenje kancelarija i objekata

Koeficijent plate: 390.00 Euro Bruto

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od nadređenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i drugih obaveza u vezi sa radnim mestom a na osnovu zahteva pretpostavljenog;
- Obavlja druge poslove na osnovu naloga rukovodstva preduzeća;
- Za poslove koje obavlja odgovoran je rukovodiocu Jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata;

Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Prijavni obrazac za NPL "Progres" Sh. A - Vučitrn. (skenirano);
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

Dokumenti koji se zahtevaju pre zasnivanja radnog odnosa:

- Uverenje o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Lekarsko uverenje.

Rok za prijavu kandidata i okviri kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana objavljivanja. Oglas je otvoren od 22.01.2025 do 05.02.2024 u 16:00 sati.

Okvirni kalendar procedure zapošljavanja:

- Prethodna verifikacija prijava kandidata najkasnije do 12.02.2025.
- Rok za žalbu je od 13.02.2025 do 18.02.2025.
- Period kada će kandidati polagati pismeni test, i kada će biti obavljena njihova evaluacija, biće najkasnije do 28.02.2025
- Rok za žalbu je od 03.03.2025 do 05.03.2025.
- Period kada će kandidati obaviti usmeni intervju i kada će biti obavljena njihova evaluacija biće najkasnije do 12.03.2025.
- Rok za žalbu je od 13.03.2025. do 17.03.2025.
- Objavljivanje konačnih rezultata za uspješnog kandidata najkasnije do 24.03.2025.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe.

U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

➤ Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu NPL "Përpلامي" Sh. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: hrperparimi@gmail.com.

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaje se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.

➤ Objašnjenje

Preduzeće ima za cilj da pojasni pitanje termina koji se koriste u rodnom aspektu, pri čemu reči i titule jednog roda uključuju i drugi rod.

➤ ZAKLJUČAK

NPL "Përpلامي" Sh. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a nevećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "GM Trade" shpk, Shtërpçë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Fabrikën e Prodhimit dhe Ambalazhimit të Ujit Mineral dhe të Gazuar, Firajë, Shtërpçë. Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14.03.2025 në ora 09:00 në objektin e Gjymnazit "Kongresi Manastirit", Firajë, Komuna e Shtërpçës, do të organizohet debat publik nga Kompania "GM Trade" shpk, Shtërpçë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3422360809>

Passcode: 617875

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "GM Trade" shpk, Shtërpçë, për Fabrikën e Prodhimit dhe Ambalazhimit të Ujit Mineral dhe të Gazuar, Firajë, Shtërpçë. <https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

